



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI  
KRYETARI

Nr. 1274 / prot  
7

Tiranë më 30.03.2022

**Lënda :** Njoftim për anulimin e mbledhjen e Këshillit për Rregullore, Mandatet dhe Imunitetin

**Drejtuar :** **Z. Arben KRAJA**  
**Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.**

**Tiranë**

I nderuar z. Kraja,

Me shkresen nr. 1274/4 Prot., u njoftuat, se mbledhja e Këshillit të Rregullores, Mandatet dhe Imunitetin do të mbledhet ditën e mërkurë, më datë 30.03.2022 ora 18:00 në ambientet e Kryesisë së Kuvendit.

Z. Alqi Bllako, me shkresen nr. 1274/5 prot, datë 30.03.2022, ka depozituar kërkesën për heqje dorë nga mandati i deputetit.

Neni 71 pika 2 shkronja b, e Kushtetutës parashikon se: "...mandati i deputetit mbaron kur deputeti heq dorë nga mandati...".

Në kushtet ku z. Alqi Bllako ka hequr dorë nga mandati i deputetit, bazuar në Rregulloren e Kuvendit, është nxjerrë urdhëri nr. 24, datë 30.03.2022, për anulimin e mbledhjes të Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, datë 30.03.2022, ora 18:00.

Ju informojmë se kërkesa për dhënien e autorizimit për arrestim, relacionit shoqërues dhe aktet bashkëlidhur (dy volume) kopjet e tyre, janë vënë në dispozicion z. Alqi Bllako.

Gjithashtu, Ju informojmë se kopje të praktikës së plotë të përcjellë nga ana juaj, i është vënë në dispozicion deputetit z. Enkelejd Alibeaj, i cili ka plotësuar deklaratën bashkëlidhur.

Kopjet e tjera të përgatituara për anëtarët e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin do të asgjesohen nga ana jonë.

Bashkëlidhur këtij njoftimi Ju dërgojmë:

- 1- Kopje të njësuar me origjinalin të kërkesës të z.Alqi Bllako për heqje dorë nga mandati i deputetit;
- 2- Urdhrin për anulimin e mbledhjes të Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin;
- 3- Dokumentacionin origjinal të dërguar nga ana juaj në Kuvend, në lidhje me kërkesën për dhënien e autorizimit për arrestim të z.Alqi Bllako (relacioni dhe aktet bashkëlidhur, dy volume).

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

**KRYETARE**

**Lindita NIKOLLA**

